

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro gjyqtar referues e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit K.L., nga Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtarë, nga neni 422 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së PTH-DKR në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- DKR në Prizren, P.nr188/15, të datës 02.11.2016 në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 24.02.2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH-DKR në Prizren, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore -DKR në Prizren, PKR.nr.188/15 , të dt.24.02.2017, vërtetohet.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore –DKR, në Prizren , PKR.nr.188/2015, të dt.02.11.2016, i akuzuari K.L., nga Prizreni, është liruar nga akuza, në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për shkak se nuk është provuar se e akuzuara, ka kryer veprën penale, për të cilën ka qenë e akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale, kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Prokuroria Themelore-DKR në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin me të cilin Kastriot Leku, është liruar nga akuza, dhe ta shpallni të njëjtin fajtorë ose që çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim gjykatës së shkallës së parë.

-Përgjigje në ankesën e PTH-DKR në Prizren, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit K.L. av.N.E., me propozim që ankesa e PTH –DKR, në Prizren , të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit e Kosovës-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj PPA/l.nr.35/17, të dt.18.01.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Prizren, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PTH-DKR, në Prizren, ndërsa përgjigja në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit K.L. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe mbajtja e seancës së kolegjit nuk është e domosdoshme.

Gjykata e Apelit, në bazë të nenit 394 par.1 të KPP, duke vlerësuar pretendimet ankimore të PTH-DKR në Prizren, dhe të përgjigjes në ankesë, të dhënë nga mbrojtësi i të akuzuarit K.L. av. N.E., edhe sipas detyrës zyrtare, e bashkë me te edhe aktgjykimin e ankimuar, e duke marr parasysh edhe mendimin me shkrim të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Prizren, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Prizren, në ankesën e saj pretendon se gjykata ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale në bazë të nenit 384 par.1 nën.1.12 KPP-ës e ka liruar nga akuza, për arsye se aktgjyrimi është i paqartë i pakuptueshëm, gjykata nuk paraqet saktë se cilat prova i besojnë, dhe nuk jep saktësinë se cilat prova iu ka besuar. Nga shkresat e lëndës, dëshmitari I.H. ka deklaruar se në dhomë ka qenë bashkë B.B., I.G. dhe A.B., i cili deklaron se në banjën e dhomës e ka vërejtur B.B. dhe të akuzuarin K.L., dhe me të dalë nga dhoma, B.B. e ka njoftuar dëshmitarin I.H. se ka telefonin në xhep, të cilin ia kishte dhënë i akuzuari K.L. dhe për këtë telefon e kishte paguar djali i tije L.B. shumën 200-250. Po ashtu i akuzuari K.L. ka zhvilluar biseda telefonike me djalin e të paraburgosurit N.K.. Ankesa pretendon se arsyetimi i aktgjyimit se është zhvilluar procedurë disiplinore për gjykatën ka qenë e mjaftueshme se për të akuzuarin K.L., është zhvilluar procedurë disiplinore gjë që për gjykatën është e mjaftueshme që ai të mos shpallet fajtor keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar. Gjendja faktike sipas ankesës nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë meqë gjykata jep besueshmëri deklaratave të paraburgosurve, ndërsa nuk u jep rëndësi fare deklaratës të dëshmitarit I.H. dhe A.B. dhe gjykata nuk merr për bazë përgjimet telefonike dhe se pas bastisjes në dhomën e të paraburgosurit në periudhën Maj 2014 janë gjetur telefonat.

Gjykata e Apelit, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Prizren, e sipas detyrës zyrtare, në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, gjen se sipas këtyre bazave ankimore ankesa është e pa qëndrueshme.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura dhe sipas detyrës zyrtare rezulton gjen se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë rreth argumentimit se i akuzuari K.L., nuk është kryes i veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK. Këto fakte mbështeten në dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, kjo për arsye se asnjëri prej dëshmitarëve SH.K., S.P., XH.K., në shqyrtimin gjyqësor e të cilët pohojnë se me dt.05.06.2014, pas vizitës familjare, mes rrobave të destinuara për të paraburgosurin A.M., është gjetur një telefon dhe në bazë të urdhrin të drejtorit është bërë kontrolli në dhomën C5, ku kanë qenë të vendosur A.B., I.H., B.B., I.G. dhe M.C. dhe sipas dëshmitarit është caktuar ekipi për të hetuar rastin dhe së bashku me ta ka qenë edhe M.Z., dhe mbikëqyrësi i lartë S.P., dhoma ka qenë më krahun C, e në të cilën dhomë është gjetur telefoni dhe sipas dëshmitarëve arsyeja që është bërë bastisja ka qenë se në pavijonin C, gjatë vizitës familjare përmes rrobave është tentuar të futet edhe një telefon, këtë e vërteton edhe dëshmitari XH.K. dhe se telefoni i cili është gjetur ka qenë i të burgosurit B.B., e këtë nuk e mohon edhe ai vet i burgosuri, se kur ka pasur vizitë familjare në dhomën e tij është gjetur telefoni mobil.

Se i akuzuari Kastriot, nuk ka dhënë në shfrytëzim telefonat e markës “Nokia” dhe “Samsung”, e në shuma të caktuara të parave prej 150-200Euro, nuk vërtetohet edhe as me prova tjera, përveç se kanë ekzistuar komunikimet nga e cila nuk mund të nxirret një konkludim i qartë se çka është biseduar në mes të akuzuarit K.L. dhe fëmijëve të paraburgosurve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, edhe po të vërtetoheshin faktet të cilat janë paraqitur në objektin e akuzës nuk mund të qëndroj vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, për mos plotësimin e kushteve ligjore, e kishte për të ekzistuar ndonjë vepër tjetër penale, po qesë të ishte vërtetuar se i akuzuari K.L., ka marrë të holla, duke i dhënë telefonat mobil të paraburgosurve, kjo për arsye se për të ekzistuar vepra penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autoritetit zyrtar, personi i cili vepron, duhet të ketë ushtruar detyra të cilat janë caktuar sipas ligjit, ndërsa në çështjen penale konkrete për të akuzuarin K.L. është akuzuar, detyrat e tij janë përcaktuar, sipas rregullave të brendshme të punës-të kodit të disiplinës të dt.01.10.2007, e në bazë të cilit Kod të disiplinës është zhvilluar edhe procedura disiplinore dhe është vetëtuar se i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me rregulloren, kjo për arsye se ai nuk ka qenë në gjendje që të kryej ndonjë veprim me tejkalimin e kompetencave ligjore, apo mos përmbushjen e detyrave zyrtare duke shkel të drejtat e personit tjetër e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Nga shkresat e lëndës nuk është kontestuese se i akuzuari K.L., ka pasur kontakte me të paraburgosurit dhe se në bazë të rregullave është e lejuar komunikimi në mes të paraburgosurve, ndërsa futja e sendeve telefonave mobil, kartelave, adapterëve ka qenë është rreptësisht e ndaluar, dhe i njëjti pranon se për shkaqe humanitare të paraburgosurve në raste të rralla u ka dhënë cigare ose medikamente mjekësore për dhimbje koke “solidamor” dhe “oki”, të cilat i ka përdorur edhe vete për qetësimin e dhembjeve dhe i ka pasur gjithmonë me vete. Po ashtu pranon se djali i të paraburgosurit N.K. i ka prurë barna mjekësore “sulidamor”, ndërsa djali i të paraburgosurit B.B., i ka sjellë tre deri në katër pako cigare, mirëpo, me rastin e futjes së këtyre sendeve ka qenë gjithmonë i kontrolluar nga ana e mbikëqyrësit XH.K., dhe mu për këto qëllime për të akuzuarin është zhvilluar për të akuzuarin K.L., është zhvilluar edhe procedura disiplinore pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të akuzuarit iu është shqiptuar masa disiplinore, për shkak të shkeljeve të rregullave të brendshme dhe i njëjti për 6(gjashtë)muaj është transferuar në qendrën e paraburgimit në Pejë.

Gjykata e shkallës së parë, ka nxjerr konkludim të drejtë se për ekzistimin e veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit, përveç se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme nuk është përmbushur edhe elementi qëllimi që duhet të ekzistoj te kryesi për ekzistimin e veprës penale, e se nuk ekziston ky qëllim, kjo mbështetet në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor të cilat janë cekur më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë konkludime të drejta dhe të qarta se nuk është provuar se i akuzuari K.L., nuk ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK dhe gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar që të akuzuarin në mungesë të provave e ka liruar nga akuza për arsye se në këtë çështje penale ekziston mëdyshje rreth asaj se i akuzuari K.L., a e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar nga ana e prokurorit të shtetit dhe në bazë të shkresave të lëndës Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim se nuk ekzistojnë prova, dhe në mungesë të tyre, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar që të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, e ankesa e PTH-DKR në Prizren, të refuzohet si e pa bazuar, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.23/2017, me dt.24.02.2017**

**Procesmbajtësi,**

\_\_\_\_\_  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Fillim Skoro**

\_\_\_\_\_  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Vahid Halili**